VENDIM
Nr.776, datë 14.12.2005

PËR VENDOSJEN E ÇMIMEVE TË REDUKTUARA TË BILETAVE TË MUZEVE PUBLIKE PËR KATEGORI TË CAKTUARA SHOQËRORE

(Ndryshuar me VKM nr. 411, datë 1.6.2011)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushetutës dhe të pikës 6 të nenit 14 të ligjit nr.9386, datë 4.5.2005 "Për muzetë", me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitojnë reduktim, në masën 50 për qind të çmimit të biletave për muzetë publikë, kategoritë e mëposhtme shoqërore:

a) Pensionistët, që gëzojnë këtë status dhe kanë dëshmi zyrtare, sipas ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) Veteranët e luftës, që gëzojnë këtë status dhe kanë dëshmi zyrtare, sipas ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", të ndryshuar;

c) Ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë, që kanë dëshmi zyrtare, identifikimi, sipas ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar;

ç) Invalidët që gëzojnë këtë status dhe kanë dëshmi zyrtare identifikimi, sipas ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", të ndryshuar;

d) Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që gëzojnë këtë status dhe kanë dëshmi zyrtare identifikimi, si dhe personat, që i shoqërojnë ata, sipas ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar;

dh) Jetimët që gëzojnë këtë status, sipas ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit", të ndryshuar;

e) Personat, që përfitojnë nga marrëveshjet dy a shumëpalëshe, të lidhura ndërmjet muzeve publikë shqiptarë dhe muzeve homologë të vendeve të tjera.

Studentët e arsimit të lartë, që kanë kartën e studentit, sipas ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nxënësit e sistemit arsimor parauniversitar, të përcaktuar sipas ligjit nr.7952, datë 21.11.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar, përfitojnë reduktim në masën 70% të çmimit të biletave.

1/1. Fëmijët deri 8 vjeç përfitojnë hyrje të lirë në muzetë publikë.

2. Shfuqizuar.

3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha